



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:011326

Datë: 10.05.2018

Numri i dokumentit: 00035723

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
QËLËKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

Më
Dana

14.05.2018

P.nr.521/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin Ilir Bytyqi si dhe procesmbajtësen Kadishe Shabani, zyrtare ligjore, në çështjen penale kundër të pandehurve [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] të gjithë nga Fshati [REDACTED], Komuna Shtime, për shkak se kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par.1 nënpar. 1.4 dhe nenin 31 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.659-5/2018 dt.13.04.2018, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur në praninë e Prokurorit të Shtetit Albert Zejnullahu, të dëmtuarit [REDACTED] me av. mbrojtës [REDACTED], si dhe të pandehurve [REDACTED] me av. mbrojtës [REDACTED] [REDACTED] me av. mbrojtës [REDACTED] [REDACTED] me av. mbrojtës [REDACTED] dhe [REDACTED] me av. mbrojtës [REDACTED] me datat 27.04.2018, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 30.04.2018 përpiloi me shkrim këtë:

AKT GJYKIM

I pandehuri: [REDACTED] i lindur me [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] me vendbanim në Fshatin [REDACTED], Komuna Shtime, me profesion punëtor fizik, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së

Kosovës, me numër personal [REDAKTUAR] në paraburgim nga data 19.03.2018 deri më datën 27.04.2018.

I pandehuri: [REDAKTUAR] i lindur me [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR] me vendbanim në Fshatin [REDAKTUAR] Komuna Shtime, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal [REDAKTUAR] në paraburgim nga data 19.03.2018 deri më datën 27.04.2018.

I pandehuri: [REDAKTUAR] i lindur me [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], me vendbanim në Fshatin [REDAKTUAR] Komuna Shtime, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal [REDAKTUAR] në arrest shtëpiak nga data 30.03.2018 deri më datën 29.04.2018.

I pandehuri: [REDAKTUAR] i lindur me [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], me vendbanim në Fshatin [REDAKTUAR] Komuna Shtime, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal [REDAKTUAR], në arrest shtëpiak nga data 19.03.2018 deri më datën 27.04.2018.

JANË FAJTOR

Se me datën 19.03.2018, rreth orës 14:30, në rrugën "Imer Devetaku" në Shtime, përballë kafiterisë "Caffe+", pas një zënke një ditë më parë në mes të pandehurit [REDAKTUAR] dhe të dëmtuarit [REDAKTUAR], të pandehurit në bashkëkryerje e kishin sulmuar me mjete të forta-shufra të drurit, mjet ky i përshtatshëm për ti shkaktuar lëndime të rënda trupore të dëmtuarit, në atë mënyrë që pasi fillojnë fjalosjen verbale e godasin me mjetë të topitur-shkop druri dhe grushte në fytyrë dhe trup të dëmtuarin [REDAKTUAR], duke e lënë të shtrirë për tokë, me ç'rast nga këto goditje i dëmtuari ka pësuar lëndime të lehta trupore, me pasojë të përkohshme për shëndetin, të përshkruar në ekspertizën mjeko-ligjore të dt. 11.04.2018.

me të cilën kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par. 1 nënpar. 1.4 dhe nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit të sipër cekur dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, e

G J Y K O N

- Të pandehurin [REDAKTUAR], dënim me burg në kohëzgjatje prej 10 /dhjetë/ Muaj, të cilin dënim do ta vuaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë, në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 19.03.2018 deri më datën 27.04.2018.
- Të pandehurin [REDAKTUAR] dënim me burg në kohëzgjatje prej 8 /tetë/ Muaj, të cilin dënim do ta vuaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë, në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 19.03.2018 deri më datën 27.04.2018.
- Të pandehurin [REDAKTUAR], dënim me burg në kohëzgjatje prej 7 /shtatë/ Muaj, të cilin dënim do ta vuaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë, në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 30.03.2018 deri më datën 29.04.2018.
- Të pandehurin [REDAKTUAR], dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 /gjashtë/ Muaj, të cilin dënim do ta vuaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë, në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 19.03.2018 deri më datën 27.04.2018.
- I dëmtuari [REDAKTUAR], nga Komuna e Shtimes, për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohen në kontest civil.
- Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 50 Euro /pesëdhjetë/ si dhe shpenzimet e procedurës penale shumën prej 20 Euro /njëzet euro ekspertiza mjeko ligjore/, në mënyrë solidare, në afat prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

- Detyrohen të akuzuarit që për kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguajnë shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, në mënyrë solidare, brenda afatit prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Arsyetimi

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

PTH në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.659-5/2018 dt.13.04.2018 ka ngarkuar të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] që të gjithë nga Fshati [REDAKTUAR], Komuna Shtime, për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 dhe neni 31 të KPRK-së, duke propozuar që të pandehurit të shpallen fajtor dhe t'u shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 25.04.2018 në të cilën shqyrtim: i akuzuari [REDAKTUAR] ka deklaruar se ka kuptuar përmbajtjen e aktakuzës dhe se nuk ka nevojë për sqarime të tjera plotësuese, ndërsa në lidhje me fajësinë e tij deklaroi se ndihet fajtor për veprën penale për te cilën e ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave të saj, po ashtu shton se është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë që mund të vijnë nga pranimi i fajësisë, derisa sa shton faktin se ndihet thellë i penduar për veprën penale të bërë dhe i kërkon falje publike të dëmtuarit në sallë të gjyqimit, me premtim që në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale po ashtu shton faktin se është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin dhe i propozon gjykatës një dënim sa më të butë.

Mbrojtësi me autorizimi i të akuzuarit [REDAKTUAR] Av. [REDAKTUAR] në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij deklaroi: i propozoj gjykatës të beje pranimin e fajësisë ndaj të pandehurit [REDAKTUAR] për faktin sa vullnetarisht është deklaruar ta pranoj fajësinë pas konsultimeve me mua si mbrojtës. Në rastin konkret unë vlerësoj se i pandehuri me pranimin e fajësisë është deklaruar se ka marr veprime të përshkruara si në dispozitiv të aktakuzës. I propozoj gjykatës të merr parasysh rrethanat e posaçme lehtësuese në kuptim të nenit 75 të KPRK-së, po ashtu si rrethane lehtësuese të merr parasysh moshën e re të të pandehurit, nuk ka rënë ndesh me ligjin me pare.

I pandehuri [REDAKTUAR] ne shqyrtimin fillestar te mbajtur me date: 25.04.2018 deklaroi se: ka kuptuar përmbajtjen e aktakuzës dhe se nuk ka nevojë për sqarime te tjera plotësuese, ndërsa ne lidhje me fajësinë e tij deklaroi se ndihet fajtor për veprën penale për te cilën e ngarkon aktakuza sipas te gjitha pikave te saj, po ashtu shton se është i vetëdijshëm për pasojat e pranimi te fajësisë qe mund te vine nga pranimi i fajësisë, ndihet thelle i penduar dhe shfrytëzon rastin ti kërkon falje publike te dëmtuarit ne salle te gjykimit, i premtori gjykatës se ne te ardhmen nuk do te përsërisë vepra penale dhe është hera e pare qe bie ndesh me ligjin si dhe i propozon gjykatës një dënim sa me te bute.

Mbrojtësi sipas detyrës zyrtare i te pandehurit [REDAKTUAR] Av. [REDAKTUAR] lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit deklaroi: e mbështes deklaratën e te pandehurit [REDAKTUAR] i cili ka pranuar fajësinë për veprën penale qe i vihet ne barre, pranimi i fajësisë është bere ne mënyre vullnetare konform dispozitave ligjore te nenit 248 te KPPK-se, si dhe pas konsultimeve te mjaftueshme me mua si mbrojtës, është penduar për veprimet e tij ne drejtim te veprës penale qe ka ndërmarr dhe premtori qe ne te ardhmen nuk do te përsërisë vepra penale.

I pandehuri [REDAKTUAR] ne shqyrtimin fillestar te mbajtur me date: 25.04.2018 deklaroi se: ka kuptuar përmbajtjen e aktakuzës dhe se nuk ka nevojë për sqarime te tjera plotësuese, ndërsa ne lidhje me fajësinë e tij deklaroi se ndihet fajtor për veprën penale për te cilën e ngarkon aktakuza sipas te gjitha pikave te saj, po ashtu shton se është i vetëdijshëm për pasojat e pranimi te fajësisë qe mund te vine nga pranimi i fajësisë, ndihem thelle i penduar shfrytëzoj rasti ti kërkoj falje publike te dëmtuarit i cili gjendet ne sallën e gjykimit, ne te ardhmen premtori se nuk do te përsërisë vepra penale dhe kjo është hera e pare qe unë bie ndesh me ligjin.

Mbrojtësi sipas detyrës zyrtare i te pandehurit [REDAKTUAR] Av. [REDAKTUAR] ne lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit deklaroi: e mbështes ne tërësi pranimin e fajësisë te te mbrojturit tim, pranimi i fajësisë është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-se dhe mbështetët ne provat e theksuara ne aktakuzë, pranimin e fajësisë e ka bere pas konsultimeve te nevojshme ne lidhje me pasojat dhe favorete qe i gëzon i pandehuri. I mbrojturi im ka shprehur keqardhje dhe po ashtu ka shprehur initiative me tere familjen qe ti përmirësojnë raportet me te dëmtuarin, nga gjykata kërkojmë te ketë parasysh këto rrethana dhe ti shqiptoj një dënim sa me te bute.

I pandehuri [REDAKTUAR] ne shqyrtimin fillestar te mbajtur me date: 25.04.2018 deklaroi se: ka kuptuar përmbajtjen e aktakuzës dhe se nuk ka nevojë për sqarime të tjera plotësuese, ndërsa në lidhje me fajësinë e tij deklaroi se ndihet fajtor për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave të saj, po ashtu shton se është i vetëdijshëm për pasojat e pranimi të fajësisë që mund të vijnë nga pranimi i fajësisë, ndihet thellë i penduar, i kërkon falje publike të dëmtuarit i cili gjendet në sallon të gjyqimit, në të ardhmen po ashtu premtonte se nuk do të përsërisë vepra penale.

Mbrojtësi me autorizim i të pandehurit [REDAKTUAR] Av. [REDAKTUAR] në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi: Konsiderojmë se do të pranohet fajësia e të pandehurit me që i njëjti vullnetarisht pas konsultimeve me mua ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barre. Duke pasur për bazë rrethanat e rastit konkret përgjegjësia penale e të pandehurit [REDAKTUAR] është tejte e vogël me që i njëjti ka pasur lëndim trupor të shkaktuar nga goditja e të dëmtuarit, është gjendur në mesin e të pandehurve të tjerë dhe se për këtë e ka pranuar edhe fajësinë, i propozoj gjykatës të merren parasysh rrethanat lehtësuese të përcaktuara me ligj dhe të aplikoj institutin e zbutjes së dënimit dhe të pandehurit të shqiptoj një dënim sa më të butë.

Prokurori i Shtetit Albert Zejnullahu lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi: pajtohem i me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve me që i njëjti pranim është i bazuar me gjendjen faktike të përshkruar në dispozitivin e kësaj aktakuze, pranimin e fajësisë të njëjtit e bënë në mënyrë vullnetare. Ngaqë një pranim i tillë është në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 248 si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të dëmtuarit [REDAKTUAR] Av. [REDAKTUAR] në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve deklaroi: si mbrojtës i të dëmtuarit propozon gjykatës që të mos pranohet fajësia e të pandehurve me arsyetim se i mbrojturi im respektivisht i dëmtuari, ka pësuar lëndime të rënda trupore bazuar në raportin CTBeni të datës : 02.04.2018 si dhe raportet në mes të të pandehurve dhe të dëmtuarit janë të acaruara sipas av. mbrojtës.

Me që të pandehurit e kanë pranuar fajësinë gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së: të pandehurit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga të pandehurit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në

materialët e prezantuar nga prokurori i shtetit, dhe në provat tjera të cilat gjenden në shkresën e lëndës siç janë: leximi dhe konstatimi i ekspertit të mjekësisë ligjore FE-280/18 i dt.11.04.2018, deklarata e të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhënë në prokurorinë shtetit e dt.01.04.2018 si dhe ajo në procedurë hetimore në policie me dt.19.03.2018, deklarata e dëshmitarit [REDAKTUAR] e dt.19.03.2018, deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] e dt.19.03.2018, deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] 19.03.2018, deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] e dt.30.03.2018, deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] me dt.19.03.2018 si dhe shkresat e tjera të cilat gjenden në dosjen e lëndës.

Me qenë se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi këtë gjendje të fakteve si në vijim: se me datën 19.03.2018, rreth orës 14:30, në rrugën "Imer Devetaku" në Shtime, përballë kafiterisë "Caffe+", pas një zënke një ditë më parë në mes të pandehurit [REDAKTUAR] dhe të dëmtuarit [REDAKTUAR] të pandehurit në bashkëkryerje e kishin sulmuar me mjete të forta-shufra të drurit, mjet ky i përshtatshëm për të shkaktuar lëndime të rënda trupore të dëmtuarit, në atë mënyrë që pasi fillojnë fjalosjen verbale e godasin me mjete të topitur-shkop druri dhe grushte në fytyrë dhe trup të dëmtuarin [REDAKTUAR] duke e lënë të shtrirë për toke, me ç'rast nga këto goditje i dëmtuari ka pësuar lëndime të lehta trupore, me pasojë të përkohshme për shëndetin, të përshkruar në ekspertizën mjeko-ligjore të dt.11.04.2018.

Në lidhje me pretendimet e av. mbrojtës të të dëmtuarit [REDAKTUAR] se ky i fundit ka pësuar lëndim të rëndë trupor për gjykatën ky pretendim është i pa bazuar duke u mbështetur në gjetjet e ekspertizës mjeko-ligjore të datës: 11.04.2018 dhe atë raporti mjekësor i prezantuar nga mbrojtja CTBeni i është prezantuar ekspertit mjeko-ligjor sipas shënimit zyrtar të

prokurorit te shtetit te bere po me date: 11.04.2018, mbi te cilin ky raport nuk e ndryshon natyrën e lëndimit trupor qe i është shkaktuar te dëmtuarit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 lidhur me par. 1 nen par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se në shqyrtimin fillestar të gjithë te pandehurit kanë pranuar fajësinë, te gjithë te pandehurit kane shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer ne bashkëkryerje, janë të moshës se re dhe kane premtuar se ne te ardhmen nuk do te përsërisin vepra penale, janë te gjendjes së dobët ekonomike, të pa punë, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese, gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurve dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurve iu shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për llogaritjen e kohës së paraburgimit respektivisht arrestit shtëpiak është marr në kuptim të dispozitës së nenit 83 par.1 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti Pergjithshem-Divizioni Penal,

P.nr.521/18 datë 30.04.2018.

Zyrtare ligjore,
Kadisha Shabani



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.